



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel: 04 22681421; 2268141

Nr. 551/5 Prot.

Tiranë, më 28.06.2017

**V E N D I M**

Nr.139, datë 28/06/2017

***"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 48, datë 13.03.2017, 'Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësit \*\*\*\*\*, protokolluar me nr. 724/3 prot., datë 23.1.2017'"***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 48, datë 13.03.2017, "Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësit \*\*\*\*\*, protokolluar me nr. 724/3 prot., datë 23.1.2017".

**VËREJ SE:**

Bazuar në informacionin e marrë nga punonjësi \*\*\*\*\*, me detyrë "Inspektor" në Sektorin e Kontrollit në Pikën e Inspektimit Kufitar pranë Drejtorisë Rajonale të AKU-së, Qarku Gjirokastrë, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka nisur verifikimin për zbatimin e ligjshmërisë së procedurës së transferimit të përkohshëm të këtij punonjësi. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 48, datë 13.03.2017, "Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësit \*\*\*\*\*, protokolluar me nr. 724/3 prot., datë 23.1.2017", në të cilin është vendosur:

1. Të kërkoj nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, që të zbatojë detyrat e lëna nga Departamenti i Administratës Publike, nëpërmjet aktit administrativ nr.6664/1 prot., datë 24.11.2016, duke vepruar në këtë mënyrë:

- Të anulohet urdhri nr. 4024, datë 4.10.2016, i Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, për transferimin e përkohshëm të punonjësit \*\*\*\*\*, nga pozicioni i punës, "Inspektor", në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Gjirokastrë, në pozicionin e punës, "Inspektor", në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me OJSH dhe Operatorëve të Biznesit, pranë kësaj drejtorie, si akt

*absolutisht i pavlefshëm, pasi ka dalë në kapërcim të kompetencave ligjore dhe në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji.*

- *Të rregullohen pasojat e krijuara nga ky akt administrativ, në dëm të nëpunësit civil \*\*\*\*\**, duke e rikthyer atë në pozicionin e tij të mëparshëm të punës.
2. *Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.*
  3. *Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat, 15 ditë.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmëruar Nr. 48, datë 13.03.2017, të Komisionerit, me Urdhrin nr. 551 prot., datë 17.05.2017, “Për verifikimin e zbatimit të Vendimit Nr. 48, datë 13.03.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, ka nisur verifikimin e zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Stela Ndoka dhe Helga Peti, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 24.05.2017, u paraqitën në insitucion. Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 551/1 prot., datë 17.05.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në institucion komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmëruar. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore, si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqëruar që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit, është materializuar në procesverbalin e datës 24.05.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personi i kontaktit të institucionit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore, të vëna në dispozicion, rezultoi se:

- Në zbatim të pikës 1, të Vendimit Nr. 48, datë 13.03.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësit \*\*\*\*\*, protokolluar me nr. 724/3 prot., datë 23.1.2017”, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit ka revokuar Urdhrin nr. 4024, datë 04.10.2016, për transferimin e përkohshëm të punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Inspektor” në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshët me Origjinë Jo Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, me Urdhrin nr. 4024/1, datë 15.05.2017, duke përfunduar periudhën e transferimit dhe vazhdimin e kryerjes së detyrës funksionale në pozicionin “Inspektor” në Sektorin e Kontrollit në Pikën e Inspektimit Kufitar pranë Drejtorisë Rajonale të AKU-së, Qarku Gjirokastrë.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 48, datë 13.03.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësit \*\*\*\*\*, protokolluar me nr. 724/3 prot., datë 23.1.2017”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të

institucionit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit janë zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

**Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

**VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit Nr. 48, datë 13.03.2017 në institucionin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 48, datë 13.03.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësit \*\*\*\*\*, protokolluar me nr. 724/3 prot., datë 23.1.2017”.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Departamenti i Administratës Publike dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**